

# Fjalë të rëndësishme i ballafaqimit me të kaluarën ←



Podgoricë, 2026.



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Centar za  
gradansko  
obrazovanje | Centre  
for Civic  
Education



# Fjalorthi

## i ballafaqimit me të kaluarën

### Botues për Malin e Zi:

Gendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

### Redaktoret për Malin e Zi:

Zvezdana Kovaç

Iris Knezheviq

### Redaksia:

Senna Shimek

Margareta Bllazheviq

### Autoret:

Margareta Bllazheviq

Eve Jones

Senna Shimek

### Produksioni i botimit për Malin e Zi:

Gendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

Botimi shqip i këtij publikimi është pjesë e projektit „**Përmes kuptimit të së kaluarës drejt ndërtimit të besimit dhe drejtësisë tranzicionale**“, në kuadër të programit rajonal „Mbështetja e BE-së për ndërtimin e besimit në Ballkanin Perëndimor“, i cili **financohet nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)**.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e ekipit të autorëve dhe QAQ-së dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e BE-së ose të UNDP-së.

Botimi i parë është publikuar në vitin 2024 nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kroaci, përmes programit Impact4Values, i cili është financuar nga EACEA, ndërsa është bashkëfinancuar nga Zyra për Shoqatat e Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

# Fjalorthik



i ballafaqimit me të kaluarën



# Hyrje

Luftërat e viteve '90 janë shumë prapa nesh, ndërsa shoqëritë në Ballkanin Perëndimor ende nuk janë ballafaquar me atë që në të vërtetë ka ndodhur në këto hapësira. Interpretimi i së kaluarës shpesh është i ngarkuar me interpretime të ndryshme, emocione dhe narrativa. Diçka heshtet, diçka thjeshtëzohet, ndërsa shumëçka edhe ndryshohet me vetëdije. Pas kaq shumë kohe, jetojmë me një të kaluar që ende kërkon bisedë, për të cilën dukshëm nuk ka mjaftueshëm hapësirë, vullnet ose guxim.

Në vend të ballafaqimit sistematik, jemi dëshmitarë të përpjekjeve të fragmentuara, të cilat më së shpeshti vijnë nga një numër i vogël individësh dhe organizatash të përkushtuara. Institucionet, nga ana tjetër, shpesh mbeten të rezervuara ose të mbyllura, veçanërisht kur bëhet fjalë për arsimin, ku mësimi i historisë jo rrallë përshtatet me nevojat e narrativave kombëtare, e më pak me faktet. Në një mjedis të tillë, është më e lehtë të zhvillohet ndjenja e viktimës kolektive sesa të merret përgjegjësi ose të hapet hapësirë për të vërteta më të ndërlikuara.

Mënyra se si flasim për të kaluarën dhe fjalët që përdorim bëhen më të rëndësishme sesa duket në shikim të parë. Prandaj, besojmë se ky *Fjalorth* mund të kontribuojë në kuptimin më të qartë të fjalëve dhe nocioneve që shpesh përdoren pa vetëdije të mjaftueshme për domethënien e tyre të vërtetë. Nuk bëhet fjalë vetëm për teori, por për gjuhën me të cilën përshkruhen ngjarje reale, përvoja dhe dilema që edhe sot e kësaj dite e formësojnë shoqërinë tonë.

Publikimi është adaptim i *Fjalorthit të ballafaqimit me të kaluarën* të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kroaci, autorëve dhe ekipit të së cilës u detyrohemi mirënjohje të veçantë që na mundësuan ta publikojmë këtë material në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, ky *Fjalorth* bëhet pjesë e një shkëmbimi më të gjerë rajonal të njohurive dhe përvojave, por edhe kontribut konkret në kontekstin lokal.

Ky *Fjalorth* u dedikohet të gjithëve: atyre që sapo hyjnë në këtë temë, por edhe atyre që i kthehen prej kohësh. Ai mund të jetë përkujtues, pikënisje ose thjesht një udhëzues i vogël përmes nocioneve që shpesh tingëllojnë të njohura, por fshehin shumë më tepër shtresa sesa duket.

Nëse ky publikim ndihmon qoftë edhe pak që disa pyetje të shtrohen më qartë, ndërsa bisedat të zhvillohen më hapur dhe me më shumë mirëkuptim, atëherë ai e ka përmbushur qëllimin e vet.

# Përmbajtja

- 7 Parathënie
- 8 Drejtësia tranzicionale
- 10 E drejta për të vërtetën
- 12 Drejtësia
- 14 Shkeljet e të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës
- 16 Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ)
- 18 Komisionet për përcaktimin e së vërtetës
- 20 Reparacionet
- 22 Garancitë e mospërsëritjes
- 23 Nisma për REKOM
- 24 Narrativat në kontekstin e drejtësisë tranzicionale
- 26 Politikat e kujtesës dhe kujtesa kolektive
- 28 Othering ose përjashtimi
- 29 Memorializimi
- 30 Revizionizmi historik
- 31 Shumëperspektiviteti
- 32 Transmetimi ndërbreznor i traumës
- 34 Politika e historisë
- 36 Nacionalizmi
- 38 Lëvizjet kundër luftës

# Parathënie

E dashur lexuese,  
i dashur lexues,

hartimi i *Fjalorthit të ballafaqimit me të kaluarën* është nxitur nga nevoja e njohur që nocionet themelore që i lidhim me drejtësinë tranzicionale të mblidhen dhe të paraqiten në një vend, në mënyrë të kuptueshme. Nocionet që mund t'i gjesh në faqet në vijim përbëjnë fjalorin e domosdoshëm të jetës shoqëro-politike, veçanërisht në vendet e krijuara pas shpërbërjes së Jugosllavisë, dhe zënë një vend të rëndësishëm në të kuptuarit e procesit kompleks dhe domethënës të ballafaqimit me të kaluarën.

Nëse të intereson dallimi ndërmjet drejtësisë retributive dhe drejtësisë restauruese, ose nëse dëshiron të mësosh më shumë për rolin e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ky Fjalorth është për ty! Njëkohësisht, nëse dëshiron të rifreskosh njohuritë e tua për këto dhe nocione të tjera, ose t'ua prezantosh ato shkurtimisht të tjerëve, je në vendin e duhur. Jemi udhëhequr nga dëshira që ky Fjalorth të jetë i dobishëm për ata që sapo hyjnë në botën e ndërlikuar të ballafaqimit me të kaluarën, por edhe që t'u shërbejë atyre me më shumë përvojë si përkujtues.

Me këtë Fjalorth dëshirojmë, gjithashtu, të nxisim dhe të frymëzojmë hulumtime të mëtejshme mbi këtë temë shumështrësore dhe interesante, por edhe të motivojmë mendimin kritik për ngjarjet e së kaluarës, si dhe vendosjen e dialogut – si për vetë të kaluarën dhe mënyrat se si ajo kujtohet, ashtu edhe për zbatimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale sot.

Në publikim janë shpjeguar 19 nocione, ndërsa faqja e fundit është lënë e zbrazët që të mund të shtosh edhe një nocion tjetër, i cili gjatë hulumtimit mund të dalë i rëndësishëm dhe i dobishëm, por nuk ka gjetur vend në Fjalorth.

Në hartimin e Fjalorthit ka marrë pjesë edhe Eve Jones, politologe dhe historiane nga Universiteti i Newcastle-it në Britaninë e Madhe, gjatë praktikës së saj në Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kroaci. Me këtë rast e falënderojmë për ndihmën dhe përkushtimin e saj!

Në emër të Nismës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut,  
Margareta Bllazheviq dhe Senna Shimek

# Drejtësia tranzicionale



Drejtësia tranzicionale është proces që synon t'u ndihmojë kombeve, shoqërive dhe individëve të kapërcejnë trashëgiminë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, të cilat janë pasojë e konflikteve të armatosura, represionit shtetëror ose trazirave politike. Disa shembuj të shkeljeve të të drejtave të njeriut janë tortura, përdhunimi dhe krimet masive (p.sh. ekzekutimet masive, përndjekja e civilëve ose gjenocidi). Përveç në shoqëritë postkonfliktuale, siç është edhe shoqëria jonë, drejtësia tranzicionale mund të zbatohet edhe në një vend që kalon nga një regjim jodemokratik në një regjim demokratik. Drejtësia tranzicionale rrit ndërgjegjësimin për trashëgiminë e konflikteve dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, krijon kushte për parandalimin e përsëritjes së tyre dhe, për këtë qëllim, fuqizon edhe vetë shoqërinë.

Nocioni i drejtësisë tranzicionale përfshin një gamë të gjerë mekanizmesh dhe procesesh, duke përfshirë procese juridike, siç janë reformat kushtetuese dhe gjyqësore, ndjekjen penale të personave përgjegjës dhe pagesën e dëmshpërblimeve. Përveç kësaj, drejtësia tranzicionale përfshin edhe themelimin e komisioneve për të vërtetën dhe pajtimin, shënimin dhe memorializimin e ngjarjeve të së kaluarës, veçanërisht të atyre që lidhen me shkeljet e të drejtave të njeriut, nismat kulturore (p.sh. muzetë tematikë), si dhe aktivitetet dhe reformat arsimore (p.sh. përfshirjen dhe trajtimin e temave të trashëgimisë së së kaluarës në arsimin joformal dhe formal, ose përshtatjen e kurrikulave).

Mekanizmat e drejtësisë tranzicionale janë të orientuar drejt njohjes dhe fuqizimit të viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut, përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet individëve dhe pajtimit, si dhe nxitjes së respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Theks i veçantë vihet edhe në ndërtimin dhe/ose përmirësimin e institucioneve shtetërore, veçanërisht të pushtetit gjyqësor dhe sektorit të sigurisë. Të

Nocioni i drejtësisë tranzicionale përfshin një gamë të gjerë mekanizmesh dhe procesesh, duke përfshirë procese juridike, siç janë reformat kushtetuese dhe gjyqësore, ndjekjen penale të personave përgjegjës dhe pagesën e dëmshpërblimeve.

gjithë mekanizmat e drejtësisë tranzicionale duhet të kenë një qëllim të përbashkët: ballafaqimin me konfliktet e së kaluarës dhe rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe vendosjen ose rivendosjen e sundimit të ligjit dhe të një rendi të qëndrueshëm shoqëror-politik në shtet.

Drejtësia tranzicionale është thelbësisht e lidhur me nocionin "ballafaqim me të kaluarën" dhe shpesh përdoret si sinonim i tij. Kjo ndodh sepse të gjithë mekanizmat e drejtësisë tranzicionale janë zhvilluar me qëllim që, në një mënyrë ose në një tjetër, të ballafaqohen me të kaluarën e dhunshme të një shoqërie.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Bachelet, M. (2020, February 13). Peacebuilding and sustaining peace: Transitional justice in conflict and post-conflict situations. Statements. Office of the High Commissioner for Human Rights. <https://www.ohchr.org/en/statements/2020/02/justice-pastcrimes-can-build-shared-future>

Blažević, M. (2022). "Hands off our holy war": The Public's Support for the Official War Narrative and Its Relationship to Transitional Justice Processes in Croatia

Clark, J.N. (2020) Re-thinking memory and transitional justice: A novel application of ecological memory. *Memory studies*, 14(4), 695-712. <https://doi.org/10.1177/17506980209581>

Cohen, C. E. (2020). Reimagining transitional justice. *International Journal of Transitional Justice*, 14(1), 1-13. <https://doi.org/10.1093/ijtj/ijaa001>.

Delaye, D. (2015). Çfarë është drejtësia tranzicionale? <https://hrcak.srce.hr/file/216941>

Quinn, J. R. (2017). The development of transitional justice. *Research handbook on transitional Justice*. <https://doi.org/10.4337/9781781955314.00008>.

Weitekamp, E. G. M., Vanspauwen, K., Parmentier, S., Valiñas, M., & Gerits, R. (2006). How to deal with mass victimization and gross human rights violations. A restorative justice approach. *NATO Security Through Science Series-E: Human and Societal Dynamics*, 13, 217-241.

# E drejta për të vërtetën




E drejta për të vërtetën mund të kuptohet si “detyrim i shteteve që t’u zbulojnë, si viktimave ashtu edhe komunitetit, çdo fakt dhe rrethanë lidhur me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut” (Latino, 2022, f. 425). E vërteta është thelbësore për viktimat (dhe/ose familjarët e tyre), si dhe për të gjithë shoqërinë, në mënyrë që të njihen përmasat e plota të shkeljeve të të drejtave të njeriut, personat përgjegjës për to dhe mënyra më e mirë për t’u ballafaquar me trashëgiminë e tyre.

E drejta për të vërtetën i referohet të gjitha shkeljeve të të drejtave të njeriut, veçanërisht në situatat kur familjarët e viktimave kërkojnë të zbulohet vendndodhja e personave të zhdukur ose e mbetjeve mortore të anëtarëve të familjeve të tyre. Në situata të tilla shpesh është i nevojshëm bashkëpunimi i shteteve (në rast të konfliktit ndërkombëtar) dhe i organeve shtetërore, në mënyrë që fati i të zhdukurve të përcaktohet sa më shpejt dhe sa më lehtë dhe që, në rast të vdekjes së tyre, familjeve të viktimave t’u mundësohet t’i varrosin.

E drejta për të vërtetën është njohur në shumë vendime juridike dhe rezoluta nga gjykata dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore. Kjo e drejtë mund të realizohet përmes procedurave gjyqësore (p.sh. përmes gjykimeve për krime lufte), si dhe përmes procedurave jashtëgjyqësore (p.sh. komisioneve për të vërtetën).

Përcaktimi i së vërtetës nxit kulturën e transparencës dhe përgjegjësisë brenda institucioneve shtetërore dhe shoqërore. Ai është element themelor dhe i domosdoshëm i procesit afatgjatë të shërimit shoqëror, bashkëpunimit dhe pajtimit. Realizimi i së drejtës për të vërtetën mund ta lehtësojë rindërtimin e besimit ndërmjet individëve, si dhe ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve shtetërore, duke mundësuar kështu zbatimin më efektiv dhe më të suksesshëm të të gjithë mekanizmave të drejtësisë tranzicionale.

E vërteta për shkeljet e të drejtave të njeriut arrihet përmes proceseve të ndryshme të përcaktimit të fakteve dhe kërkimit të së vërtetës. Këto procese nënkuptojnë zhvillimin e mekanizmave efikasë që mundësojnë përcaktimin e plotë, të bazuar në prova, të së vërtetës për regjimet e mëparshme



politike, ngjarjet e luftës dhe, më e rëndësishmja, rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Gjatë përcaktimit të së vërtetës, përmes zbatimit të mekanizmave përkatës, është e nevojshme të përcaktohen faktet objektive për kryesit e krimeve, fatin e viktimave dhe kontekstin në të cilin janë kryer krimet. Përmes këtyre proceseve formësohet edhe një narrativë historike për konfliktet e armatosura dhe/ose represionin shtetëror, e bazuar në prova.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Blažević, M. (2022). "Hands off our holy war": The Public's Support for the Official War Narrative and its Relationship to Transitional Justice Processes in Croatia.

Horne, C. M. (2017). Building trust and democracy: Transitional justice in post-communist countries. Oxford University Press.

Latino, A. (2022). Genealogy, variations and specificity of the right to truth. Athens Journal of Law, 8(4), 425–448. <https://doi.org/10.30958/ajl.8-4-5>.

Naqvi, Y. (2006). The right to the truth in international law: Fact or fiction? International Review of the Red Cross, 88(862), 245–273. <https://doi.org/10.1017/s1816383106000518>.

Parmentier, S., Valiñas, M., & Weitekamp, E. (2009). How to repair the harm after violent conflict in Bosnia? Results of a population-based survey. Netherlands Quarterly of Human Rights, 27(1), 27–44. <https://doi.org/10.1177/016934410902700103>.

# Drejtësia



Në kontekstin shoqëror postkonfliktual dhe tranzicional, realizimi i drejtësisë për shkeljet e të drejtave të njeriut përbën parakusht themelor për paqe të qëndrueshme dhe pajtim. Qasja në drejtësi është një e drejtë themelore e njeriut dhe mekanizëm kyç për mbrojtjen dhe sigurimin e respektimit universal të të drejtave të tjera individuale të njeriut. E drejta siguron mbrojtjen e individëve nga cenimi i të drejtave të tyre dhe u mundëson "korrigjimin e padrejtësive civile, thirrjen e pushtetit ekzekutiv në përgjegjësi, si dhe mbrojtjen në procedurë penale" (Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe Këshilli i Evropës, 2016, f. 15). Kjo e drejtë zbatohet në të drejtën civile, administrative dhe penale.

Ekzistojnë dy "lloje" të realizimit të drejtësisë që përmenden shpesh në fushën e drejtësisë tranzicionale: drejtësia retributive dhe drejtësia restauruese. Drejtësia retributive bazohet në rivendosjen e drejtësisë dhe sundimit të ligjit përmes ndëshkimit të kryesve të krimeve. Ideja që qëndron pas saj është se kryesit duhet të ndëshkohen në përpjesëtim me peshën e veprës së kryer dhe pasojat e saj. Në të kundërt, drejtësia restauruese është e orientuar drejt korrigjimit të "padrejtësisë së shkaktuar nga krimet dhe shkeljet". Qëllimi i drejtësisë restauruese është riparimi i dëmit të shkaktuar, plotësimi i nevojave të palëve të përfshira, ndërsa në qendër të procesit vendoset viktimja (Weitekamp et al., 2006, f. 9).

Përcaktimi i përgjegjësisë së kryesve për shkeljet e të drejtave të njeriut përmes procedurave gjyqësore përbën një nga mekanizmat më të zakonshëm të drejtësisë retributive. Qëllimi i këtyre procedurave është realizimi i drejtësisë për viktimat, luftimi i pandëshkueshmërisë, rivendosja e sundimit të ligjit dhe forcimi i legjitimitetit të institucioneve. Kjo nënkupton ndjekjen penale dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për shkelje individuale ose sistematike të të drejtave të njeriut, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë individuale për krimet.

Këto procese kanë edhe funksionin e njohjes së dëmit dhe humbjeve që kanë pësuar viktimat, të përcaktimit të së drejtës së tyre për kompensim të dëmit, pra reparacion, si dhe të nxitjes së respektimit të të drejtave të njeriut në shoqërinë demokratike të sapokrijuar. Procedurat penale mund të zhvillohen në nivel ndërkombëtar - para tribunalëve si Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) - si dhe para gjykatave kombëtare.

Përveç gjykatave ndërkombëtare dhe shtetërore, komuniteti ndërkombëtar më herët ka mbështetur edhe themelimin e gjykatave hibride - si Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës - në të cilat punon personel ndërkombëtar dhe vendor, dhe të cilat zbatojnë të drejtën materiale dhe procedurale ndërkombëtare dhe kombëtare.

Një mekanizëm tjetër i drejtësisë tranzicionale është procesi i lustracionit (ose verifikimit). Përmes këtij procesi përcaktohet përgjegjësia politike e bartësve të funksioneve publike dhe nëpunësve shtetërorë të përfshirë në abuzime institucionale të lidhura me konfliktet ose shkeljet e të drejtave të njeriut, duke kontribuar kështu në reformën e institucioneve shtetërore.

Ky proces mund të rrisë legjitimitetin e rendit të ri demokratik dhe të institucioneve të tij, të dërgojë një mesazh të qartë kundër pandëshkueshmërisë politike dhe të rikthejë besimin e qytetarëve/eve në institucionet publike. Komisionet për përcaktimin e së vërtetës janë mekanizmi më i përdorur në kuadër të drejtësisë restauruese. Ato janë organe jashtëgjyqësore, detyra e të cilave është të përcaktojnë faktet për shkeljet e të drejtave të njeriut, si dhe shkaqet dhe pasojat e tyre për shoqërinë. Ato veprojnë si "forum publik për viktimat dhe kryesit e krimeve", me qëllim nxitjen e dialogut për ngjarjet, shërimin ndërnjerëzor dhe rindërtimin e marrëdhënieve shoqërore (Weitekamp et al., 2006, f. 12).

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Pjesë të këtij teksti janë marrë dhe përshtatur nga hulumtimi i realizuar nga njëra prej autoreve të këtij publikimi (Margareta Bllazheviq): Blažević, M. (2022). "Hands off our holy war": The Public's Support for the Official War Narrative and its Relationship to Transitional Justice Processes in Croatia. Punim diplome i hartuar në Free University Amsterdam, Netherlands.

European Union Agency for Fundamental Rights and Council of Europe. (2016). Handbook on European law relating to access to justice. <http://fra.europa.eu/en/publication/2016/handbook-european-law-relating-access-justice>

United Nations Development Programme Bureau for Crisis Prevention and Recovery (UNDP). (2005). Vetting public employees in post-conflict settings. Operational guidelines. United Nations Development Programme (UNDP). <https://www.ictj.org/sites/default/files/ICTJ-UNDP-Global-Vetting-Operational-Guidelines-2006-English.pdf>

Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights (OHCHR). Rule-of-law tools for post-conflict states. Maximizing the legacy of hybrid courts. OHCHR. <https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/HybridCourts.pdf>.

Weitekamp, E. G. M., Vanspauwen, K., Parmentier, S., Valiñas, M., & Gerits, R. (2006). How to deal with mass victimization and gross human rights violations. A restorative justice approach. NATO Security Through Science Series-E: Human and Societal Dynamics, 13, 217-241.

Wenzel, Michael, Okimoto, T. G., Feather, N. T., & Platow, M. J. (2008). Retributive and restorative justice. Law and Human Behavior, 32(5), 375-389.

# Shkeljet e të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës



Të drejtat e njeriut, të cilat duhet t'u mundësohen dhe t'u garantohen të gjithë individëve, janë përcaktuar në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të miratuar si përgjigje ndaj krimeve masive dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ky dokument përfaqëson një standard të përbashkët drejt të cilit duhet të synojnë të gjithë popujt dhe shtetet, dhe përcakton të drejtat e çdo individit, ndër të tjera, për liri, jetë, siguri, drejtësi, liri të lëvizjes dhe liri të shprehjes. Kur këto të drejta shpërfillen ose nuk mbrohen, ndodh shkelja e tyre.

Në kontekstin e regjimeve represive ose konflikteve të armatosura, në shkeljet e të drejtave të njeriut më së shpeshti përfshihen organet shtetërore, si policia, ushtria dhe institucione të tjera shtetërore, por edhe aktorë parashitetërorë, si grupet paramilitare ose organizatat terroriste. Shkeljet e të drejtave të njeriut mund të kenë karakter dhune fizike (p.sh. brutaliteti policor, dhuna ndaj civilëve nga forcat e armatosura), por mund të jenë edhe jodhunore (p.sh. mohimi i së drejtës për gjykim të drejtë). Shkeljet e të drejtave të njeriut mund të kryhen drejtpërdrejt, kur bëhen me qëllim, ose tërthorazi, kur nuk janë parandaluar me sukses.

Si format më të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut konsiderohen cenimet e të drejtave civile dhe politike. Të drejtat civile përfshijnë të drejtën për jetë, siguri dhe barazi para ligjit, ndërsa të drejtat politike, për shembull, përfshijnë të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën e votës

Si format më të rënda të shkeljeve të të drejtave të njeriut konsiderohen cenimet e të drejtave civile dhe politike.

dhe të drejtën për tubim dhe bashkim paqësor. Cenimet e të drejtave civile dhe politike mund të shfaqen, ndër të tjera, përmes torturës ose vrasjes së individëve dhe grupeve, si dhe përmes ndalimit arbitrar ose përndjekjes. Përveçse në shtetet me regjime politike represive, shkelje të tilla ndodhin shpesh gjatë konflikteve të armatosura - kur kualifikohen si krime lufte.

Lista e cenimeve të të drejtave të njeriut që, në kontekstin e konfliktit të armatosur, kualifikohen si krime lufte gjendet në të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe në konventat ndërkombëtare të së drejtës penale, si dhe në të drejtën ndërkombëtare zakonore. Më të rëndësishmet në këtë drejtim janë Konventat e Gjenevës, të cilat i kanë ratifikuar të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara. Sipas Konventave të Gjenevës, krimet e luftës përfshijnë shkelje të rënda ("grave breaches"), si vrasja e qëllimshme, tortura ose trajtimi çnjerëzor, shkatërimi dhe përvetësimi i pronës, si dhe shkelja e ligjeve dhe zakoneve të luftës, duke përfshirë, për shembull, drejtimin e qëllimshëm të sulmeve kundër popullsisë civile dhe objekteve civile.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:


Human Rights Careers (2022). What are human rights violations? <https://www.humanrights-careers.com/issues/what-are-human-rights-violations/>

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. [https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/](https://www.ohchr.org/sites/default/files/UDHR/Documents/UDHR_Translations/cnr.pdf)

Documents/UDHR\_Translations/cnr.pdf United Nations. (n.d.). United Nations Office on Genocide Prevention and the responsibility to protect. United Nations. <https://www.un.org/en/genocideprevention/war-crimes.s.html>

Përmbledhje e Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe e protokolleve të tyre shtesë. <https://www.hck.hr/UserDocImages/publikacije/sazetak.pdf>

# Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ)



Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), i njohur edhe si Tribunali i Hagës, ishte tribunal ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara që trajtonte krimet e kryera gjatë konflikteve në territorin e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Mandati i TPNJ-së përfundoi në vitin 2017, pas së cilës procedurat e mbetura të apelit i mori përsipër Mekanizmi Ndërkombëtar Rezidual për Gjykatat Penale (IRMCT). TPNJ-ja paraqiti aktakuza kundër 161 personave, gjë që rezultoi me 93 vendime dënuese dhe 18 vendime liruese, ndërsa 13 lëndë iu transferuan gjykatave kombëtare. Ndaj 37 të akuzuarve procedurat u ndërpre në ose ata ndërruan jetë. Të gjithë të akuzuarit e TPNJ-së iu dorëzuan Tribunalit dhe asnjë person nuk është më në arrati. TPNJ-ja kishte hetues profesionistë, të cilët në terren, në shtetet e ish-Jugosllavisë, mbledhnin prova dhe kërkonin dëshmitarë. Megjithatë, ky tribunal nuk kishte policinë e vet, por për arrestimin e të dyshuarve mbështetej në bashkëpunimin e institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, si dhe të forcave policore dhe paqeruajtëse.

Gjatë mandatit të tij, TPNJ-ja vendosi precedente të rëndësishme në të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe luajti rol kyç në zhvillimin e praktikës gjyqësore në fushën e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit.

Për shembull, Tribunali zgjeroi përkufizimet dhe masat ndëshkuese për kryesit e dhunës seksuale, përcaktoi se skllavëria seksuale dhe përndjekja përbëjnë krime kundër njerëzimit, si dhe saktësoi rregullat e procedurës në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe pranimin e fajësisë. TPNJ-ja ndryshoi në mënyrë të qëndrueshme infrastrukturën juridike të drejtësisë ndërkombëtare në fushën e shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura.

Po aq e rëndësishme është se TPNJ-ja u mundësoi viktimave të dëshmonin për krimet dhe të ndanin përvojat e tyre para një tribunali ndërkombëtar. Ai siguroi që personat që mbanin përgjegjësinë më

të madhe për krimet të ndiqeshin penalisht dhe të dënoheshin. I themeluar në vitin 1993, ndërkohë që konfliktet ende vazhdonin, TPNJ-ja kishte edhe rol parandalues - të vepronte si faktor frenues ndaj atyre që mund të kryenin krime.

Pas përfundimit të punës së TPNJ-së, mandatin e tij e mori përsipër **Mekanizmi Ndërkombëtar Rezidual për Gjykatat Penale (IRMCT)**, i cili, përveç lëndëve të mbetura të TPNJ-së, mori përsipër edhe kompetencat e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR).

Në vitet e para të veprimtarisë së tij, Mekanizmi punoi paralelisht me TPNJ-në dhe TPNR-në, ndërsa pas mbylljes së këtyre tribunaleve vazhdoi punën si institucion i pavarur. Përmes funksioneve të shumta që vazhdon t'i kryejë, Mekanizmi synon të ruajë trashëgiminë e këtyre dy tribunaleve ndërkombëtare, të informojë dhe edukojë komunitetet e prekura nga krimet, si dhe të ofrojë mbështetje për institucionet kombëtare në ndjekjen penale të krimeve të luftës.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Clark, J. (2014). International trials and reconciliation: Assessing the impact of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia. Routledge.

International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia. (n.d.). Achievements. <https://www.icty.org/en/about/tribunal/achievements>

Mekanizmi Ndërkombëtar Rezidual për Gjykatat Penale (2024). Rreth Mekanizmit.

<https://www.irmct.org/bcs/o-mehanizmu>

Stahn, C., Agius, C., Brammertz, S., and Rohan, C. (Eds.). (2020). Legacies of the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia: A multidisciplinary approach. Oxford University Press.


# Komisionet për përcaktimin e së vërtetës



Komisionet për përcaktimin e së vërtetës janë organe hetimore jashtëgjyqësore dhe të pavarura, të cilat më së shpeshti themelohen për të përcaktuar faktet dhe kontekstin lidhur me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe krimet. Anëtarët e komisioneve të ngarkuara me përcaktimin e së vërtetës dhe nxitjen e pajtimit në shoqëri kanë autorizime për të zhvilluar hetime, për t'u ofruar mbështetje viktimave dhe për të propozuar rekomandime politike me qëllim parandalimin e përsëritjes së krimeve. Përmes hetimeve të tyre, komisionet synojnë të zbulojnë hollësitë për shkeljet e të drejtave të njeriut, t'i njohin ato zyrtarisht dhe të përcaktojnë arsyet e ndodhjes së tyre, si dhe personat përgjegjës për to. Komisionet për të vërtetën merren gjithashtu me hetime për zhdukjet me forcë, rastet e torturës dhe marrjet në pyetje të paligjshme e të dhunshme, ekzekutimet jashtëgjyqësore dhe krime të tjera, me qëllim që familjeve të viktimave t'u ofrojnë informacione për fatin e tyre. Komisionet mund të ndihmojnë edhe në procedurat penale dhe të rekomandojnë reforma institucionale, por kryesisht orientohen drejt nevojave të viktimave dhe procesit të pajtimit. Pas hetimeve, viktimat dhe kryesit e krimeve zakonisht dëgjohen para përfaqësuesve të komunitetit, nxitet dialogu, ndërsa nga kryesit kërkohet të kërkojnë falje dhe të pranojnë përgjegjësinë për krimet e kryera.

Përmes hetimeve të tyre, komisionet synojnë të zbulojnë hollësitë për shkeljet e të drejtave të njeriut, t'i njohin ato zyrtarisht dhe të përcaktojnë arsyet e ndodhjes së tyre, si dhe personat përgjegjës për to

Shembujt më të njohur të veprimtarisë së këtyre komisioneve janë proceset Gacaca në Ruandë dhe Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin në Republikën e Afrikës së Jugut. Në



Ruandë vepruan rreth 12.000 komisione lokale, të cilat shqyrtuan pothuajse dy milionë raste të lidhura me gjenocidin e vitit 1994.

Vetëm përmes procedurave penale shpesh është e vështirë të zbulohet përmasa e plotë e krimeve të kryera gjatë periudhave të dhunës, represionit dhe luftës. Gjykatat dhe tribunalet, për shkak të kufizimeve financiare dhe organizative, mund të trajtojnë vetëm një numër të kufizuar rastesh. Përcaktimi i së vërtetës së plotë dhe i përmasave të veprave penale është i domosdoshëm për realizimin e drejtësisë për të gjitha viktimat. Komisionet për përcaktimin e së vërtetës nuk e zëvendësojnë nevojën për ndjekje penale, por përbëjnë një mekanizëm plotësues të drejtësisë tranzicionale, i cili ndihmon në realizimin e qëllimeve të proceseve gjyqësore dhe kontribuon në shërimin, rivendosjen e paqes, bashkëpunimin dhe besimin në shoqëri.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Androff, D. K. (2010). Truth and reconciliation commissions (TRCs): An international human rights intervention and its connection to Social Work. *British Journal of Social Work*, 40(6),1960–1977. <https://doi.org/10.1093/bjsw/bcp139>.

Parmentier, S. (2001). The South African truth and reconciliation commission. Towards restorative justice in the field of human rights. In Fattah, E. & Parmentier, S. (Eds.). *Victim policies and criminal justice on the road to restorative Justice. Essays in honour of Tony Peters*. Leuven University Press.

Rowen J. (2017). *Searching for truth in the transitional justice movement*. Cambridge University Press. <https://doi.org/10.1017/9781316258279>.

# Reparacionet



Reparacionet, përkatësisht dëmshpërblimi i viktimave, konsiderohen kyçe për realizimin e drejtësisë në periudhën postkonfliktuale dhe tranzicionale, si dhe për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Reparacionet mund të jenë në formë materiale, si kthimi i pronës së marrë në mënyrë të paligjshme, sigurimi dhe financimi i mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, si dhe e drejta për rehabilitim psikologjik dhe fizik. Gjithashtu, reparacionet mund të realizohen edhe përmes masave simbolike, që kanë për qëllim garantimin e mospërsëritjes së krimeve dhe njohjen e vuajtjes së viktimave - për shembull, përmes kërkesave publike për falje nga zyrtarët politikë dhe shtetërorë. Çdo formë e dëmshpërblimit ka vlerë të veçantë për viktimat, ndërsa kombinimi i masave materiale dhe simbolike ka potencialin më të madh për të nxitur ndjenjën e drejtësisë dhe për të kontribuar në shërimin shoqëror. Përmes reparacioneve tregohet se viktimat janë dëgjuar, se përvojat dhe nevojat e tyre janë marrë parasysh, si dhe se humbjet dhe vuajtjet e tyre janë pranuar. Të gjitha viktimat, përkatësisht anëtarët e familjeve të tyre, duhet të kenë të drejtë ligjore dhe morale për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e shkeljes së të drejtave të tyre të njeriut dhe të të drejtave të më të afërmeve të tyre.


## Shembuj të kërkesave publike për falje

Baza e kërkesave politike për falje: [https://www.politicalapologies.com/?page\\_id=74](https://www.politicalapologies.com/?page_id=74).

Germanyapologisesforcolonial-eragenocideinNamibia.Reuters.Retrievedfrom:<https://www.reuters.com/world/africa/germany-officially-calls-colonial-era-killings-namibia-genocide-2021-05-28/>

Sterling, T. (2023, July 1). King apologises for The Netherlands' historic role in slavery. Reuters. <https://www.reuters.com/world/europe/king-apologises-netherlands-historic-role-slavery-2023-07-01/>

Dëmshpërblimet duhet të jenë në përpjesëtim me peshën e shkeljeve dhe përmasat e dëmit të pësuar. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, në rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut (si krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidi), reparacionet nuk janë kompensim për vuajtjen e përjetuar, por akt simbolik i njohjes së përgjegjësisë dhe i pendesës së sinqertë.



Edhe pse përbëjnë element kyç të drejtësisë tranzicionale, dëshmipërblimet bëhen dukshëm më efektive kur shoqërohen me procese si komemorimet dhe me mekanizma për përcaktimin e së vërtetës dhe përgjegjësisë për krimet.

Kërkesat publike për falje përbëjnë një instrument të fuqishëm reparacioni, i cili mund të nxisë rishqyrtimin kritik të së kaluarës kombëtare dhe të rolit të saj në zhvillimin demokratik të shoqërisë. Ato shprehin publikisht keqardhje dhe pendesë, si dhe shërbejnë si akt i njohjes së vuajtjes së viktimave dhe përgjegjësisë së shtetit për shkaktimin e saj ose për mosparandalimin efektiv të saj. Kërkesa të tilla për falje kontribuojnë në proceset e shërimit shoqëror dhe në rikthimin e dinjitetit që viktimave u është mohuar përmes shkeljes së të drejtave të tyre të njeriut. Kërkesat publike për falje përbëjnë një akt simbolik në të cilin përfaqësuesit politikë ose grupet e kryesve (për shembull ushtria), që kanë kontribuar në shkeljet e të drejtave të njeriut ose nuk i kanë parandaluar ato, me vetëdije e vendosin autoritetin e tyre në funksion të pajtimit dhe shërimit shoqëror.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Danieli, Y. (2020). Massive trauma and the healing role of reparative justice: An update. In Reparations for Victims of Genocide, War Crimes and Crimes against Humanity (38-85). Brill [https://doi-org.vu-nl.idm.oclc.org/10.1163/9789004377196\\_004](https://doi-org.vu-nl.idm.oclc.org/10.1163/9789004377196_004).

Ferstman, C., & Goetz, M. (2020). In Reparations for victims of genocide, war crimes and crimes against Humanity. Brill.

UN OHCHR. (2008). Rule-of-law tools for post-conflict states: Reparations programmes. Global Reparations Programmes. <https://www.ictj.org/sites/default/files/UNHCHR-Glob al-Reparations-Programmes-2008-English.pdf>

# Garancitë e mospërsëritjes



Garancitë e mospërsëritjes përfaqësojnë zotimin e shtetit se rastet e mëparshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut, veçanërisht gjatë konflikteve të armatosura, nuk do të përsëriten më kurrë. Këto garanci mund të konsiderohen masë afatgjatë e drejtësisë tranzicionale, sepse përmes tyre shtetet marrin përgjegjësi për veprim të vazhdueshëm dhe aktiv në zhvillimin dhe zbatimin e politikave parandaluese.

Garanci të tilla mund të realizohen përmes masave konkrete, duke përfshirë ndryshimet ligjore me të cilat sigurohet që dhuna dhe konfliktet të mos mund të përsëriten. Garancitë nënkuptojnë edhe ndërhyrje shoqërore të orientuara drejt forcimit të rolit të shoqërisë civile, ndërprerjes së sulmeve dhe ngacmimeve ndaj aktorëve të shoqërisë civile, si dhe fuqizimit të grave, vajzave dhe grupeve të tjera që më parë kanë qenë të përjashtuara nga mbrojtja ligjore.

Garancitë e mospërsëritjes realizohen përmes një sërë masash parandaluese, si reforma e institucioneve, përmirësimi i mekanizmave për zgjidhjen paqësore të konflikteve, shpërbërja e grupeve të armatosura joformale, si dhe zbatimi i procesit të lustracionit në sektorët e sigurisë dhe të drejtësisë. Gjithashtu, është e rëndësishme që shtetet të hulumtojnë shkaqet themelore të dhunës dhe të bashkëpunojnë me shoqërinë civile në hartimin e politikave dhe nismave të orientuara drejt parandalimit të konflikteve.

## Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Davidovic, M. (2021). The law of 'Never Again': Transitional justice and the transformation of the norm of non-recurrence. *The International Journal of Transitional Justice*, 15(2), 386–406. <https://doi.org/10.1093/ijtj/ijab011>.

Mayer-Rieckh, A. (2017). Guarantees of non-recurrence: An approximation. *Human Rights Quarterly*, 39(2), 416–448. <https://doi.org/10.1353/hrq.2017.0024>.

Roht-Arriaza, N. (2016). Measures of non-repetition in transitional justice. *From Transitional to Transformative Justice*, 105–130. <https://doi.org/10.1017/9781316676028.005>.

UN OHCHR. (2021). Guarantees of non-recurrence. *Guarantees of non-recurrence: OHCHR and transitional justice*. <https://www.ohchr.org/en/transitional-justice/guarantees-non-re-currence>

# Nisma për REKOM

REKOM është nismë rajonale që ka për qëllim përcaktimin e fakteve për të gjitha viktimat e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në territorin e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ), në periudhën nga 1 janari 1991 deri më 31 dhjetor 2001. REKOM synon të përcaktojë fakte për të kaluarën që do të ishin të pranueshme për të gjithë popujt dhe shtetet e prekura nga konfliktet. Ky rrjet rajonal hulumtuesish dhe organizatash joqeveritare ka qenë jashtëzakonisht aktiv dhe i suksesshëm në proceset e kërkimit të së vërtetës, përcaktimit të fakteve dhe ndërtimit të pajtimit në rajon. Nisma ka përfaqësues në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Serbi, Slloveni dhe Kosovë, dhe përbën rrjetin më të madh të organizatave joqeveritare në vendet e ish-Jugosllavisë, me më shumë se 2.200 anëtarë dhe anëtarë. Më shumë se gjysmë milioni qytetare dhe qytetarë nga të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë e kanë mbështetur me nënshkrimet e tyre themelimin e REKOM-it.

## Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Balkan Investigative Reporting Network. (2019). After the ICTY: Accountability, truth and justice in former Yugoslavia. <https://birn.eu.com/outputs/after-the-icty-accountability-truth-and-justice-in-former-yugoslavia/>.

RECOM. (2022). What is RECOM? About RECOM. <https://www.recom.link/>

# Narrativat në kontekstin e drejtësisë tranzicionale



Narrativat në kontekstin e drejtësisë tranzicionale përfaqësojnë rrëfime për ngjarjet dhe interpretime të këtyre ngjarjeve, si dhe të të dhënave që lidhen me to. Rrëfime të tilla mund të formësohen nga individë ose grupe përmes bisedave të përditshme, por edhe nga politikanët përmes fjalimeve publike. Narrativat mund të gjenden edhe në tekstet shkollore, në mediat sociale dhe tradicionale, në filma, dokumentarë, si dhe në raportet e politologëve dhe historianëve. Narrativat janë "dritare drejt mendjeve dhe shoqërisë" (Hammack dhe Pilecki, 2012, f. 76) dhe nuk njohin kufizime as në zhvillimin e tyre, as në ndikimin e tyre. Mbi bazën e narrativave ndërtohet kujtesa kolektive e grupeve të caktuara shoqërore, e cila ndikon në mënyrën se si anëtarët e tyre e interpretojnë të kaluarën dhe të tashmen. Për më tepër, narrativat mund të kenë ndikim të fuqishëm në formimin e identitetit shoqëror të individëve - njerëzit pranojnë rrëfime dhe kujtime që shpjegojnë përkatësinë e tyre ndaj grupeve të caktuara shoqërore (p.sh. etnike), qoftë mbi bazën e bindjeve, vlerave kolektive ose normave të pranuar. Me fjalë të tjera, individët pranojnë kornizën normative dhe karakteristikat e grupit të formësuar përmes narrativave dominuese.


Në psikologjinë politike dallohen dy lloje themelore të narrativave:

Narrativat top-down - të imponuara nga elita politike

Narrativat bottom-up - që zhvillohen brenda grupeve shoqërore dhe ndërmjet individëve

Narrativat mund të jenë individuale ose zyrtare.

Mbi bazën e narrativave ndërtohet kujtesa kolektive e grupeve të caktuara shoqërore, e cila ndikon në mënyrën se si anëtarët e tyre e interpretojnë të kaluarën dhe të tashmen.



Narrativat individuale (personale), i referohen interpretimeve personale të ngjarjeve të kaluara (p.sh. luftës) dhe ndryshojnë nga një person te tjetri. Ato krijohen mbi bazën e përvojës së drejtpërdrejtë, por edhe nën ndikimin e burimeve të tjera - narrativave zyrtare, kujtimeve familjare, marrëdhënieve shoqërore dhe përkatësisë ndaj një grupi të caktuar.

Narrativat zyrtare janë ato që prodhohen dhe promovohen nga elita politike dhe që shpesh paraqiten si e vetmja e vërtetë e lejuar për ngjarjet e së kaluarës. Narrativa të tilla më së shpeshti mund të gjenden në programet mësimore shtetërore, deklaratat politike dhe ligjet.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Pjesë të këtij teksti janë marrë dhe përshtatur nga hulumtimi i realizuar nga njëra prej autoreve të këtij publikimi (Margareta Bllazheviq): Blažević, M. (2022). "Hands off our holy war": The Public's Support for the Official War Narrative and its Relationship to Transitional Justice Processes in Croatia. Punim diplome i hartuar në Free University Amsterdam, Netherlands.

Ashplant, T., Dawson, G. & Roper, M. (Eds.). (2000). The politics of war memory and commemoration. Routledge. <https://doi-org.vu-nl.idm.oclc.org/10.4324/9780203770115>.

Hammack, P. L., & Pilecki, A. (2012). Narrative as a root metaphor for political psychology. *Political Psychology*, 33(1), 75–103. <https://doi-org.vu-nl.idm.oclc.org/10.1111/j.1467-9221.2011.00859.x>.

Shenhav, S. R. (2006). Political narratives and political reality. *International Political Science Review*, 27(3), 245–262. <https://doi.org/10.1177/0192512106064474>

# Politikat e kujtesës dhe kujtesa kolektive




Politika e kujtesës është fushë teorike e përkushtuar studimit dhe kuptimit të mënyrës se si kujtesa vepron në ndërthurje me sjelljen politike – përkatësisht mënyrës se si kujtesa përdoret për të formësuar qëndrimet politike, e rrjedhimisht edhe veprimin dhe sjelljen politike. Me kujtesën subjektive mund të manipulohet, ajo mund të përshtatet, madje edhe të ndryshohet plotësisht, duke shërbyer si faktor kyç në krijimin e legjitimitetit dhe fuqisë politike.

Kjo fushë hulumton strategjitë dhe mjetet që përdorin aktorët politikë për t'i orientuar individët që t'i kujtojnë dhe memorializojnë ngjarjet në një mënyrë të caktuar. Politika e kujtesës studion edhe pasojat psikologjike dhe shoqërore-politike të strategjive dhe manipulimeve të tilla. Brenda kësaj fushe, nocioni më i rëndësishëm që përdoret dhe hulumtohet është kujtesa kolektive.

Kujtesa kolektive përfaqëson tërësinë e kujtimeve të përbashkëta të anëtarëve të një grupi të caktuar. Këto grupe mund të jenë të vogla (p.sh. familja ose mjedisi i punës) ose të mëdha (p.sh. partia politike ose bashkësia etnike). Kujtimet kolektive krijohen përmes komunikimit dhe ndërveprimit brenda grupit dhe bazohen në identitetin e përbashkët. Kujtesa kolektive ka rol të rëndësishëm në formësimin dhe riformësimin e identiteteve individuale dhe kolektive.

Kujtesa kolektive mund të ketë rol integrues, sepse lidh anëtarët e së njëjtës bashkësi, por mund të përdoret edhe për përjashtimin e atyre që nuk identifikohen me narrativën dominuese. Gjithashtu, kujtimet kolektive mund të transmetohen nga një brez te tjetri - gjë që quhet transmetim ndërbreznor i kujtesës kolektive. Për aktorët politikë, kujtesa kolektive përbën një mjet të fuqishëm në ndërtimin e mbështetjes masive politike, sepse ata zgjedhin në mënyrë strategjike "anën e ndritshme ose të errët të ngjarjeve të spikatura historike, për të formësuar kujtesën kolektive në përputhje me status quo-në politike" (Belmonte dhe Rochlitz, 2019, f. 230).



Kujtesa kolektive ka vend të veçantë në fushën e drejtësisë tranzicionale. Drejtësia tranzicionale analizon kujtimet kolektive të grupeve të caktuara në shoqëritë postkonfliktuale, për të kuptuar mënyrën se si kujtohen dhe interpretohen konfliktet e kaluara, shkaqet e tyre dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Këto njohuri janë kyçe për vlerësimin kritik të mekanizmave të zbatuar të drejtësisë tranzicionale dhe të domosdoshme gjatë zhvillimit të tyre të mëtejshëm, sepse kujtesa kolektive mund të ndikojë ndjeshëm në rezultatet përfundimtare të këtyre proceseve.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Belmonte, A. & Rochlitz, M. (2019). The political economy of collective memories: Evidence from Russian politics. *Journal of Economic Behavior and Organization*. 168, 229-250. <https://doi.org/10.1016/j.jebo.2019.10.009>

Connerton, P. (1989). *How societies remember*, Cambridge University Press. Halbwachs, M., & Coser, L. A. (2022). *On collective memory*. The University of Chicago Press.

Verovšek, P. J. (2020). Collective memory as a resource for political change. *Memory and the Future of Europe*. <https://doi.org/10.7765/9781526143112.00007>

Zubrzycki, G., & Woźny, A. (2020). The Comparative Politics of Collective Memory. *Annual Review of Sociology*, 46(1), 175–194. <https://doi.org/10.1146/annurev-soc-121919-054808>

# Othering ose përjashtimi



Othering, ose përjashtimi, përfaqëson procesin në të cilin aktorët politikë krijojnë, promovojnë dhe nxisin publikun të pranojë narrativa që marginalizojnë dhe përjashtojnë një grup të caktuar njerëzish nga bashkësia, përkatësisht nga shoqëria dominante. Narrativa të tilla kanë për qëllim ta paraqesin një grup të caktuar si “të tjerët” - si ata që nuk i përkasin bashkësisë, që nuk mund dhe nuk duhet të jenë pjesë e saj dhe që, për këtë arsye, lejohet të përjashtohen dhe të marginalizohen.

Othering është mekanizëm që elitat politike shpesh e përdorin për të përgatitur si forcat e armatosura (p.sh. ushtrinë dhe policinë), ashtu edhe publikun e gjerë, për shkelje të të drejtave të njeriut ose për tolerimin, shpërfilljen dhe justifikimin e tyre. Ky proces çon në ndarje të thella shoqërore dhe në përjashtimin e “të tjerëve” nga bashkësia, ndërsa mund të rezultojë edhe në dehumanizimin e pjesëtarëve të grupeve të përjashtuara, gjë që shpesh çon drejt dhunës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Ky mekanizëm përdoret edhe në rrethana postkonfliktuale dhe tranzicionale - për shembull, përmes diskriminimit të viktimave të “kombësisë tjetër” në realizimin e së drejtës për dëmshpërblim për vuajtjen e përjetuar dhe/ose dëmin material. Një praktikë e tillë përbën pengesë të rëndësishme për zbatimin e drejtësisë tranzicionale.

## Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Berenskoetter, F. (2014). Parameters of a national biography. *European Journal of International Relations*, 20(1), 262–288. <https://doi.org/10.1177/1354066112445290>

Kagedan. (2020). *The politics of othering in the United States and Canada*. Springer International Publishing.

Murphy, C. C., & Green, P. (2011). *Law and outsiders norms, processes and “othering” in the 21st century*. Bloomsbury Publishing Plc.

# Memorializimi

Në shtetet me histori të shkeljeve të të drejtave të njeriut, kultivimi i vazhdueshëm i kujtesës për të kaluarën është kyç për realizimin e së drejtës për të vërtetën, drejtësinë, dëmshpërblimin dhe garancitë e mospërsëritjes. Ata që harrojnë të kaluarën janë të dënuar ta përsërisin atë, ndërsa memorializimi nxit ballafaqimin me konfliktet e së kaluarës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut përmes identifikimit, njohjes dhe kujtimit të tyre publik, duke kontribuar kështu në parandalimin e përsëritjes së tyre.

Memorializimi përbën mekanizëm themelor të ballafaqimit me të kaluarën, sepse ofron hapësirë për kujtim, pikëllim dhe mësim – si për ata që janë prekur drejtpërdrejt nga dhuna, ashtu edhe për brezat e ardhshëm. Format e nismave memoriale “mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në muze, ceremoni komemorative, kërkesa për falje, riemërtime të hapësirave publike, rivarrime dhe projekte kujtese”, si dhe mekanizma të tjerë mnemonikë të përshtatur me nevojat e komunitetit (Naidu, 2016, f. 11).

Memorializimi gjithëpërfshirës – që nënkupton njohjen dhe kujtimin e të gjitha viktimave – përbën një themel të rëndësishëm për zhvillimin e kulturës demokratike dhe është pjesë e pandashme e përpjekjeve të orientuara drejt realizimit të drejtësisë, shërimit shoqëror, pajtimit, reparacioneve dhe ballafaqimit me të kaluarën.

## Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Naidu, E. (2016). From memory to action: A toolkit for memorialisation in post-conflict societies. From memory to action. ICTJ. <https://www.sitesofconscience.org/wp-content/uploads/2016/08/Memorialization-Toolkit-English.pdf>.

OHCHR. (2020). Expert: Memory is a key pillar for healing, democracy and peace. OHCHR. <https://www.ohchr.org/en/stories/2020/10/expert-memory-key-pillar-healing-democracy-and-peace>.

# Revizionizmi historik



Revizionizmi historik përfaqëson përpjekjen për ndryshimin, vënien në dyshim, reinterpretimin ose rishqyrtimin e fakteve historike të përcaktuara shkencërisht për ngjarje të caktuara historike. Ekzistojnë dy lloje të revizionizmit historik - legjitim dhe jolegjitim (ose negativ). Revizionizmi historik legjitim bazohet në ndryshimin e narrativave ekzistuese historike kur shfaqen dëshmi të reja dhe të besueshme, të cilat e arsyetojnë ndryshimin e interpretimeve të pranuar më parë. Në këto raste, ndryshimi vjen si rezultat i hulumtimeve shkencore dhe i punës së historianëve, të bazuar në burime dhe fakte të reja.

Revizionizmi historik jolegjitim ose negativ i referohet ndryshimit, vënies në dyshim, reinterpretimit dhe falsifikimit të vetëdijshëm dhe të qëllimshëm të fakteve historike të vërtetuara shkencërisht, me qëllim realizimin e interesave ideologjike dhe politike. Në këtë rast, bëhet fjalë për manipulim të fakteve historike të bazuara në dëshmi, pa asnjë mbështetje shkencore.

Në kontekstin rajonal të ish-Jugosllavisë, revizionizmi historik shpesh përdoret si mjet politik përmes mohimit ose relativizimit të fakteve të përcaktuara gjyqësisht për krimet e luftës, rolin e formacioneve të caktuara ushtarake ose ngjarjet e luftërave në tërësi. Në këtë mënyrë, aparatet shtetërore, elitat politike ose partitë politike synojnë të (ri)konstruktojnë narrativën historike, me qëllim formësimin e kujtesës kolektive dhe orientimin e publikut drejt një ideologjie ose vizioni të caktuar për të ardhmen.

## Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Cipek, T. (2019). Revizionizmi historik në Bosnjë dhe Hercegovinë. Politika socialdemokrate e kujtesës ndërmjet dy totalitarizmave. <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/15658.pdf>

Arribas, C. M., Arcos, R., Gétrudix, M., Mikulski, K., Hernández-Escayola, P., Teodor, M., Novăcescu, E., Surdu, I., Stoian, V., & García-Jiménez, A. (2023). Information manipulation and historical revisionism: Russian disinformation and foreign interference through manipulated history-based narratives. *Open research Europe*, 3, 121. <https://doi.org/10.12688/openreseurope.16087.1>

Cattini, G.C. (2011). "Historical Revisionism: The Reinterpretation of History in Contemporary Political Debate." *Transfer Journal of Contemporary Culture*, 6, 30.

# Shumëperspektiviteti

Siç tregon edhe vetë emërtimi, zbatimi i qasjes shumëperspektive nënkupton marrjen parasysht të perspektivave të tjera, përveç asaj personale. Niset nga supozimi se çdo pozicion - përfshirë edhe tonin - formësohet nga vlera të caktuara, modele kulturore, kontekst shoqëror dhe përvoja personale, dhe se për këtë arsye është i prirur ndaj anshmërisë. Ky nocion hyn në kontekstin e arsimit gjatë viteve nëntëdhjetë të shekullit XX, si rezultat i kërkimit të mënyrave të përshtatshme për të paraqitur së bashku, në mësimdhënien e historisë, përvojat dhe narrativat e palëve që kanë qenë në konflikt. Rezultati i një qasjeje të tillë është një paraqitje më e ndërlikuar dhe më e plotë e së kaluarës, e bazuar në narrativa të ndërthurura, që tregon ekzistencën e interpretimeve të ndryshme dhe shpesh të kundërta për të njëjtat ngjarje, si dhe kufizimet që shpesh i mbart me vete "historia monokulturore" ose "monoetnike". Në nivel evropian është arritur konsensus se shumëperspektiviteti duhet të jetë qasja themelore metodologjike në tekstet e historisë, përkatësisht se ato duhet të përmbajnë burime që paraqesin këndvështrime dhe interpretime të ndryshme të të njëjtave ngjarje në shtete të ndryshme, në vend të paraqitjes së një "të vërtete konsensuale" që duhet pranuar pa rishqyrtim.

## Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Stradling, R. (2005). Shumëperspektiviteti në mësimdhënien e historisë. Zagreb, Evropa Qendrore. Koren, S. (2014). "Çfarë na mëson historia? Mësimdhënia e historisë, idetë mbi të nxënit/mësimdhënien dhe rezultatet e të nxënit - doracak për mësimdhënësit." Zagreb, Profil Klett.

Koren, S. (2011). "Pamjet e historisë kombëtare në tekstet shkollore kroate para dhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë." Përmbledhje historike, 60.

Stradling, R. (2005). Shumëperspektiviteti në mësimdhënien e historisë. Zagreb, Evropa Qendrore.

Šimek, S. (2023). "Krijimi i mitologjemave për Luftën Atdhetare në periudhën 2000–2020." Punim diplome i shkruar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Zagrebit.

# Transmetimi ndërbreznor i traumës




Transmetimi ndërbreznor i traumës në kontekstin e drejtësisë tranzicionale nënkupton procesin e transmetimit të përvojave traumatike të dhunës politike ose luftës nga brezi që i ka përjetuar drejtpërdrejt te brezat e ardhshëm, të cilët nuk e kanë pasur një përvojë të tillë. Kur ndodh transmetimi ndërbreznor i traumës, pasardhësit mund të shfaqin simptoma të traumës përmes reagimeve emocionale, psikologjike dhe fizike të lidhura me përvojat e prindërve, gjysheve ose gjyshërve të tyre, madje edhe të përjetojnë në nivel psikologjik aspekte të caktuara të traumave të paraardhësve të tyre.

Ky proces më së shpeshti është i pavetëdijshëm dhe zhvillohet përmes mekanizmave të ndryshëm: biologjikë (gjenetikë); psikologjikë (p.sh. përmes pasojave të stresit dhe çrregullimeve mendore tek paraardhësit); familjarë (p.sh. përmes humbjes së prindërve ose anëtarëve të tjerë të familjes si pasojë e luftës ose dhunës politike); dhe faktorëve shoqërorë (p.sh. për shkak të tensioneve politike, varfërisë ose marrëdhënieve të paqëndrueshme shoqërore në mjedisin postkonfliktual).

Trauma ndërbreznore përbën pasojë serioze dhe afatgjatë të ngjarjeve si luftërat, gjenocidi, skllavëria, dhuna seksuale, kolonializmi ose represioni politik. Ajo paraqet rrezik të

Trauma ndërbreznore përbën pasojë serioze dhe afatgjatë të ngjarjeve si luftërat, gjenocidi, skllavëria, dhuna seksuale, kolonializmi ose represioni politik.



rëndësishëm për shëndetin publik dhe e vështirëson seriozisht procesin e shërimit shoqëror, pajtimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të komunitetit.

Është e rëndësishme të theksohet se trauma nuk transmetohet domosdoshmërisht në çdo rast. Në përmasën dhe gjasat e transmetimit ndikon e ashtuquajtura qëndrueshmëri psikologjike e personit që e ka përjetuar drejtpërdrejt traumën dhe e personit tek i cili ajo "trashëgohet", përkatësisht aftësia e tyre për t'u përballur me stresin dhe për të krijuar mekanizma mbrojtjeje dhe rimëkëmbjeje.

#### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Buljubašić, M., & Holá, B. (2023). Trauma kolektive transgjenerative dhe radikalizimi në Bosnjë dhe Hercegovinë: drejt vendosjes së një kornize për analizë. *Tema Kriminalistike*, 23(1-2), 71-91. <https://doi.org/10.51235/kt.2023.23.1-2.71>

Daniele Y. (ed). (1998). *International Handbook of Multigenerational Legacies of Trauma*. Boston, MA: Springer US.

de Mendelssohn F. (2008). Transgenerational transmission of trauma: guilt, shame, and the "heroic dilemma". *International Journal of Group Psychotherapy*, 58 (3):389-401.

# Politika e historisë



Politika e historisë është disiplinë brenda shkencave politike që merret me studimin e mënyrës se si shtetet bashkëkohore raportohen ndaj së kaluarës së tyre kombëtare, veçanërisht ndaj aspekteve të saj problematike dhe të errëta, si regjimet totalitare ose rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Kjo fushë merret me analizën e mënyrës se si narrativat dhe interpretimet e ngjarjeve historike përdoren për qëllime politike - për shembull, për të arsyetuar qëndrime të caktuara politike, pozicione ideologjike, vendime politike ose konkurrencë politike. Megjithatë, politika e historisë nuk merret me atë nëse këto narrativa janë të vërteta, por me mënyrën se si ato instrumentalizohen për qëllime politike dhe se si, përmes formave simbolike, ndikojnë në formësimin e vullnetit politik dhe bindjeve të qytetarëve.

Në këtë kuptim, politika e historisë studion se si shtetet përballen me të kaluarën e tyre të dhunshme - qoftë përmes shtypjes kolektive, injorimit dhe mohimit (modele negative të ballafaqimit), qoftë përmes rishqyrtimit kritik, pajtimit dhe

Kjo fushë merret me analizën e mënyrës se si narrativat dhe interpretimet e ngjarjeve historike përdoren për qëllime politike - për shembull, për të arsyetuar qëndrime të caktuara politike, pozicione ideologjike, vendime politike ose konkurrencë politike.

ballafaqimit aktiv me trashëgiminë e së kaluarës (p.sh. përmes ndjekjes penale të kryesve dhe dëmshpërblimit të viktimave).

Politika e historisë ka disa dimensione, përkatësisht fusha kërkimi: politiko-arsimore, politiko-instrumentale dhe politiko-administrative. Dimensioni politiko-arsimor merret me çështjen se cilat përmbajtje historike do të përfshihen në programet arsimore dhe si do t'u mësohen të rinjve në institucionet shtetërore të arsimit. Dimensioni politiko-instrumental studion përdorimin e së kaluarës në formësimin e simboleve politike dhe në luftën për dominim në diskursin publik. Dimensioni politiko-administrativ përfshin vendimet për vendet memoriale kombëtare, qendrat memoriale dhe festat shtetërore, si dhe konceptimin e muzeve historike.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Kasapović, M. (2019). Historia, revizionizmi historik dhe politikat e historisë. Časopis za suvremenu povijest, 51 (3), 939-960. Marrë nga <https://hrcak.srce.hr/230076>

Cipek, T. (2007). Politikat e historisë në Republikën e Kroacisë: Od "Puška puče" do "Hristos se rodi" // Kultura e kujtesës: thyerjet historike dhe tejkalimi i së kaluarës. Milosavljević, Olivera (ur.). Zagreb: Disput, 2007. f. 13-27

# Nacionalizmi



Nacionalizmi nënkupton një lëvizje ideologjike dhe politike që promovon unitetin, besnikërinë dhe përkushtimin ndaj kombit, interesave, të drejtave dhe historisë së tij të përbashkët. Ai nxit zhvillimin dhe afirmimin e vetëdijes kombëtare dhe identitetit kolektiv. Nacionalizmi thekson veçanërisht vlera si feja, shteti dhe hapësira territoriale, ndërsa në kontekstin bashkëkohor shpesh mbron vendosjen e kombit të vet, kulturës, interesave dhe të drejtave të tij mbi popujt dhe shtetet e tjera. Një nga karakteristikat kryesore të nacionalizmit është prirja për diskriminimin e kombeve të tjera ose pjesëtarëve të kombësive të tjera brenda të njëjtit shtet, gjë që mund të çojë në marginalizimin e pakicave kombëtare, por edhe në konflikte me shtetet fqinje, përfshirë edhe konfliktet e armatosura.

Ideologjia e nacionalizmit e ndan botën ekskluzivisht përmes prizmit të përkatësisë kombëtare dhe thekson dallimet ndërmjet popujve (p.sh. kulturore, gjuhësore ose fetare), ndërsa njëkohësisht marginalizon gjithçka që nuk përshtatet me identitetin kombëtar dominues - si pakicat kombëtare ose grupet alternative shoqërore. Çdo gjë që nuk përshtatet me normat që imponon identiteti kombëtar bëhet "tjetri" dhe vendoset në kategorinë "ata", përballë kategorive "ne" dhe "tanët".

Nacionalizmi është i lidhur ngushtë me procesin e othering-ut (përrjashtimit), përkatësisht me praktikën e ndarjes së njerëzve brenda shoqërisë në "ne" dhe "ata".

Është e rëndësishme të theksohet se nacionalizmi nuk duhet të barazohet me patriotizmin. Ndërsa nacionalizmi është ideologji ose drejtim politik, patriotizmi nënkupton dashurinë ndaj vendit dhe popullit, lidhjen emocionale me vlerat, kulturën dhe historinë, por edhe veprimin e orientuar drejt përmirësimit të komunitetit. Patriotizmi nuk nënkupton diskriminimin e të tjerëve dhe as nuk presupozon dhënien e përparësisë kombit të vet në raport me popujt e tjerë.

### Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:

Miscevic, N.,(2023). "Nationalism", The Stanford Encyclopedia of Philosophy,. Zalta, N., E. & Nodelman, U. (Eds.). <https://plato.stanford.edu/archives/fall2023/entries/nationalism>

Kecmanovic, D. (1996). What Is Nationalism?. In: The Mass Psychology of Ethnonationalism. Path in Psychology. Springer, Boston, MA. [https://doi.org/10.1007/978-1-4899-0188-0\\_2](https://doi.org/10.1007/978-1-4899-0188-0_2)

YIHR Kroaci. [Zërat e të rinjve] A është atdhedashuria vetëm dashuri ndaj atdheut apo diçka më shumë? <https://www.yihr.hr/hr/glasovi-mladih-je-li-domoljublje-samo-ljubav-prema-domovini-ili-vise-od-toga>

# Lëvizjet kundër luftës



Lëvizja kundër luftës është lëvizje shoqërore që lind si përgjigje, por edhe si protestë kundër vendimit të shtetit për të nisur ose për të marrë pjesë në një konflikt të armatosur. Ajo nënkupton veprim kolektiv të një grupi njerëzish, të cilët përmes aktiviteteve të organizuara, jashtë strukturave politike institucionale, mbrojnë ndërprerjen e pjesëmarrjes së shtetit në luftë ose parandalimin e shpërthimit të konfliktit. Për këtë qëllim organizohen protesta dhe aksione të tjera shoqërore në nivel lokal ose kombëtar, me synimin për të ushtruar presion mbi elitën politike që të ndalë veprimet luftarake ose të parandalojë shpërthimin e tyre.

Lëvizjet kundër luftës mund të kenë motive të ndryshme. Disa e kundërshtojnë luftën sepse e konsiderojnë të padrejtë, të paligjshme ose tepër të kushtueshme - si në aspektin financiar, ashtu edhe për shkak të humbjeve të jetëve njerëzore. Të tjerët janë të motivuar nga parime më të gjera të pacifizmit, përkatësisht nga bindja se çdo formë dhune është e pamoralshme dhe se konfliktet duhet të zgjidhen përmes dialogut, kompromisit dhe bashkëpunimit. Këto dallime në motivim shpesh ekzistojnë edhe brenda vetë lëvizjeve kundër luftës, ndërmjet pjesëmarrësve të tyre.

Lëvizja kundër luftës nënkupton veprim kolektiv të një grupi njerëzish, të cilët përmes aktiviteteve të organizuara, jashtë strukturave politike institucionale, mbrojnë ndërprerjen e pjesëmarrjes së shtetit në luftë ose parandalimin e shpërthimit të konfliktit.

## Literatura e përdorur dhe rekomandime për hulumtim të mëtejshëm:


Bojan Bilić dhe Vesna Janković: Rezistenca ndaj së keqes: angazhimi kundër luftës në hapësirën (post)jugosllave, Zagreb (2015): Jesenski i Turk, Kuća ljudskih prava i Documenta

Bojan Bilić: Luftuam për ajër: aktivizmi kundër luftës në hapësirën (post)jugosllave dhe trashëgimia e tij , Zagreb (2015): Jesenski i Turk, Kuća ljudskih prava i Documenta

Paul Stubbs: "Civil society or Ubleha", në: 20 Pieces of Encouragement for Awakening and Change: Peacebuilding in the Region of the Former Yugoslavia. ur. Helena Rill et al. (Belgrade/Sarajevo: Centre for Nonviolent Action, 2007), str. 215–228

YIHR Srbija.(2022) Lëvizjet kundër luftës dhe aksionet kundër luftës gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë. <https://yibr.rs/bhs/antiratni-pokreti-i-akcije-protiv-rata-tokom-raspada-jugoslavije>





**Fjalorhi**  
i ballafaqimit me të kaluarën





